

Evalda Paci

**Shaban Sinani, Akademikë dhe vepra të tyre
në albanologji, Akademia e Shkencave e Shqipërisë,
Tiranë, 2022**

Përmbledhja studimore me titull *Akademikë dhe vepra të tyre në albanologji*, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, 2022 përbën një prej silozhave më përfaqësuese të kontributeve të Shaban Sinanit në disa disiplina studimore në albanologji, ndër të cilat historia e shkrimit, historia e letërisë, vëmendja ndaj pasurive arkivore në institucione të kërkimit shkencor në vendin tonë, por dhe homazhet ndaj figurash themelore në historinë e studimeve albanologjike, spikasin në mënyrë të qartë. Autori ka gjetur natyrshëm një rrugë të reflektimit të shkrimeve që janë më së pari të natyrës studimore dhe orientojnë në mënyrë të peshuar në një raport mes trajtesash që lidhen me pasionet më të hershme hulumtuese të tij dhe atyre të mëvona, me të cilat kurrsesi nuk mund të thuhet se është shënuar një vijë ndarëse me sprovat më të para në fushë të studimeve më specialistike.

Ndarja në tri pjesë kryesore e trajtesave të përfshira në këtë vëllim nuk është gjithsesi shterruese në vështrim të ndihmesave që studiuesi Shaban Sinani ka dhënë në dekadat e fundit dhe veçanërisht në vitet më të fundit, gjatë të cilave ka realizuar në cilësinë e organizuesit një sërë veprimtarish shkencore që kanë bërë të mundur të gjenden në rolin e bashkëpunuesit jo pak institucione të kërkimit shkencor e të mësimdhënies universitare në vendin tonë e në areale më të gjera të kulturës në Evropë.¹

Duke konsideruar parësore ndihmesat e studiuesve të albanologjisë që përuan interpretimet më të para të tyre mbi çështje të gjenezës së gjuhës e të popullit tonë, por dhe mbi metodologjinë e gjurmimit të teksteve më të vjetra

¹ Shih në veçanti *Shenjim hyrës* nga autori, në *Akademikë dhe vepra të tyre në albanologji*, (Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2022): Lënda që përmban ky libër është shkruar përgjatë më shumë se tri dekadave. Përmban shkrime për 50 autorë dhe vepra të studiuesve akademikë, që kanë lënë gjurmë në studimet albanologjike. Shkrimet më të hershme u takojnë veprave të E. Çabejt, Sh. Demirajt, A. Budës, Dh. S. Shuteriqit. Më i hershmi është shkruar në vitin 1988.

shqipe në dekadat e para të shekullit të kaluar, autori Sinani i ka evidentuar këto të fundit në pjesën e parë të vëllimit të sipërcituar.

Në këtë pjesë të parë të botimit me titull *Akademikë dhe vepra të tyre në albanologji*, e që u kushtohet gjuhëtarëve dhe filologëve, do të mund të konsultohen trajtesat: *Për mendimin e kryehershëm historiko-letrar të Eqrem Çabejt*; *Kur dhe si u shturën qerthujt letrarë*; *Histori e gjuhës si histori e popullit*; *Çabeji ynë, model vlerësimi i studiuesit për studiuesin*; *Drejtues shkencor si Shaban Demiraj*; *Gjuhëtari që ndërlihd shkollat e studimit të shqipes*; *Vrojtime antropogjuhësore për ndërveprimin e shqipes si gjuhë në kontakt*; *Danezi që ringjalli veprat e Pjetër Budit*; *Një vepër me rëndësi për kalendarin e shqipes*; *Dy studime në dorëshkrim të Dh. S. Shuteriqit*; *Sytë e Simonidës dhe Kush e solli Doruntinën - një vështrim krahasues*; *Tri ligjërata universitare nga Mahir Domi*; *Kangjelji VII: nga De Rada te Kupitori, Mitko, Pekmezi e Jochalas*; *Urat e Arbërit: Kur shqiptarët u rindjenë të njëri-tjetrit*; *Letërsia arbëreshe si urë ndërmjet sistemeve letrare*; *Letërsia e vjetër shqipe në shkrime e tejkshkrime të Rexhep Ismajlit*; *Kur arkeonimi arbanë e humbi gjithëpërfshirjen*; *Dialektet si bartës kulture: E folmja e Reç-e-Dardhës në kërkimet e Bahri Becit*; *Për zbatimet tradicionale në antroponimi*; *Të jesh brenda eposit dhe gjuhës së kreshnikëve*; *Fjalori i shqipes së Faik Konicës*.

Shkrimet e mësipërme, pavarësisht faktit që janë konkretizuar në momente të ndryshme të rrugëtimit hulumtues të autorit, janë pjesë e vetëdijes për të evidentuar çdo linjë qenësore në studimet albanologjike, tek të cilat konvergojnë natyrshëm gjurmimet mbi gjenezën e gjuhës dhe të popullit tonë, sprovat për të rindërtuar një histori të shkrimit të shqipes, ndërlihdjet mes disiplinave që plotësojnë njëra-tjetrën në mënyra të ndryshme e falë rezultatesh konkrete; reflektimet mbi lidhjet e natyrshme mes dukurive e fenomeneve të zhvillimeve letrare dhe në trevat arbëreshe; qasje metodologjike ndaj shfaqjesh të veçanta në fushë të antroponimisë etj. Shtysë për përpilimin e sprovave të mësipërme kanë qenë tubime shkencore në nderim të figurave themelore në historikun e gjurmimeve albanologjike, por dhe vetë prirja e autorit për të shënuar e evidentuar me anë reflektimesh të thelluara çka mendonte për prurjet e reja në këto të fundit, disa prej të cilave dhe të vlerësuara prej tij në cilësinë e recensentit shkencor. Në rasë të trajtimit tërësor dhe analitik të ndihmesave të figurave të rëndësishme në historinë e studimeve albanologjike, sigurisht nuk mund të ketë një vijë të prerë mes gjurmimeve të kryera dhe në këtë vështrim vetë trajtesat mbi personalitete si Eqrem Çabej dhe Mahir Domi e përforcojnë bindshëm vetëdijen që nuk mund të shihen në mënyrë të shkëputur prirjet studimore në rrugëtimin e secilit.²

² Shih në veçanti “Për mendimin e kryehershëm historiko-letrar të Eqrem Çabejt”, në *Akademikë dhe vepra të tyre në albanologji*, (Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2022), 11-19. Në këtë shkrim që mban vitin 1990 në përmbyllje të tij

Ndër argumentet ndaj të cilave vëmendja e studiuesit tonë nuk ka munguar asnjëherë ka qenë pikërisht historia e letërsisë së shkruar shqipe, e evidentuar për rëndësinë e saj ndër trajtesat më të fundit të tij, por e bërë sërish objekt vëmendjeje në kumtimet dhe kushtimet ndaj figurave të rëndësishme si Dh. Shuteriqi, M. Domi, R. Ismajli, B. Demiraj, G. Svane etj.

Historia e shkrimit të shqipes, por dhe historia e gjuhës shqipe kanë qenë që në krye të herës pjesë e interesave studimore të Shaban Sinanit, duke qenë dhe bashkëkohës i personaliteteve që kanë lënë pas kontribute qenësore sa i përket trajtimit thellësisht objektiv dhe shkencor të prejardhjes së shqiptarëve dhe reflektimit të autoktonisë së tyre ndër shekuj, bashkë me çështje të vlerësimit përkatës nga tradita e kohës dhe në kontekste në të cilat njohja e studimeve tona mbetet po aq e rëndësishme.

Të tilla ndihmesa të Shaban Sinanit, të radhitura dhe në një pasqyrë që merr në konsideratë dhe rendin disiplinor, janë një kujtesë për theksimin e njohjes së arritjeve të paraardhësve, të cilat lanë pas gjurmë të një pune të palodhur e fort të çmuar për brezat.

Kur dhe si u shturën qarqet letrare, e përfshirë në pjesën kushtuar gjuhëtarëve dhe filologëve, përbën një trajtesë që jo vetëm orienton vëmendjen ndaj reflektimit mbi fakte që kanë të bëjnë me historikun e përvijimit të lëvizjeve kulturore me ndikim në vepra konkrete të shkruara a të përpiluara në shqip, por dhe në një çështje tjetër, po aq me rëndësi që ka të bëjë me njohjen e ndërsjellë nga ana e autorëve apo e censorëve të veprave të kësombllave që kanë dalë në dritë të shtypit në kohë të përafërta. Sa njiheshin ekzemplarët që kishin të bënin me doktrinën, katekizmin, liturgjinë dhe sakramendet, sa qarkullonin dhe si mund të pasqyroheshin të tilla njohje duhen shtruar me të drejtë dhe në rasë të trajtimit historik e analitik të qarqeve letrare në shekuj më të hershëm, të konceptuar dhe nga studiues të historisë së letërsisë shqipe sipas një përkatësie komplekse, të lidhur dhe me arealin, dhe me prurjet gjuhësore e letrare që dëshmohen në vepra të caktuara.

Kjo çështje është rikthyer dhe së fundmi në vëmendjen e gjurmuesve të dokumentimit shkrimor të shqipes, që mëtojnë të dëshmojnë dhe të dhëna të reja mbi rrugëtimin individual të prelatëve të letrave shqipe, për shkollimin e të

evidentohen natyrshëm kontributet më të hershme të E. Çabejt, në veçanti ato të viteve '30 të shekullit të kaluar, me të cilat fillon e përvijohet profili i një studiuesi të dijes së albanologjisë, që nuk lë jashtë vëmendjes elementet e gjuhësisë dhe të literaturës sonë, me dëshmitë më të hershme përkatëse të dokumentuara e të trajtuara dhe në këtë periudhë në doracakë studimorë të filologjisë e të studimit të teksteve dhe nga studiues të të njëjtave disiplina në rrethet akademike evropiane. I të njëjtit vit (1990) është dhe trajtesa me titull *Çabeji ynë, model vlerësimi i studiuesit për studiuesin*, që i kushtohet veprës së Sh. Demirajt për E. Çabejn.

cilëve kanë ardhur dhe më të plota indice të lidhura me kolegjet e edukimit klerikal në shekullin XVII.

Në trajtesën me titull *Danezi që ringjalli veprat e Pjetër Budit*, renditur sërish ndër vështrimet që i përkasin historikut të kontributeve mbi tekstet më të hershme shqipe dhe çështje të riprodhimit ekdotik e filologjik të tyre, studiuesi Sinani e introdukton lexuesin dhe me elemente të një njohjeje më të hershme të tij me emrin e veprimtarinë e Gunnar Svanes (1927-2012), i cili përgjatë viteve '80 të shekullit të kaluar, me një bashkëpunim të frytshëm me profesor Shaban Demirajn, arrin të përmbyllë një punë madhore me tekstet e Pjetër Budit, të cilat e kishin vënë atë para një sprove madhore si në pikëpamje të zgjidhjeve fonetike e fonologjike që kërkoheshin në proces të një transliterimi korrekt e të plotë të tyre, ashtu dhe të interpretimeve që duheshin dhënë në lidhje me brendinë e veprës në fjalë.³

Prania e kontributeve të Gunnar Svanes do të receptohet dhe në artikuj e shkrime shkencore që u sollën për botim në revistat shkencore shqiptare, ndër të cilat spikasin dhe ato kushtuar *Pasëqyrës së të Rrëfyemit*, të botuara pikërisht në vitin 1980 në *Studia Albanica*.⁴

Tri ligjërata universitare nga Mahir Domi, është një trajtesë që përpiket të evidentojë një trashëgimi komplekse të lënë për brezat nga Mahir Domi, me interesa studimore që cekin çështje të historisë së gjuhës shqipe e të njohjes përkatëse në qerthuj shkencorë evropianë, vështrime mbi historinë e letërsisë së shkruar shqipe e veçanërisht çështje të periodizimit të saj⁵, me gjithë terminologjinë përkatëse që përfshihet në këtë rasë, studime tematike mbi autorë të rëndësishëm të kësaj letërsie (ndër të tjera, dhe dorëshkrimi mbi Pjetër Bogdanin),⁶ por dhe trajtesa të përveçme mbi drejtshkrimin e shqipes. Me

³ Sh. Sinani, "Danezi që ringjalli veprat e Pjetër Budit", në *Akademikë dhe vepra të tyre në albanologji*, (Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2022), 80-89.

⁴ Shih gjithashtu dhe G.Svane, "Formimi i gjuhës letrare shqipe siç paraqitet në "Pasqyrën e të rrëfyemit" të Budit (1621)". *Studime Filologjike*, n.3, (1982).

⁵ Sh. Sinani, "Tri ligjërata universitare nga Mahir Domi", në *Akademikë dhe vepra të tyre në albanologji*, (Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2022), 118: M. Domi ka mendime origjinale për periudhizimin e përgjithshëm të historisë së letërsisë shqipe dhe për karakterizimin e çdo periudhe një pas një. Në vështrimin e Mahir Domit, tradita letrare deri në shekullin e romantizmit mund të konsiderohet si një periudhë e vetme, periudha parakombëtare, ide që është rikthyer kohët e fundit në diskutimet shkencore për një histori të re të letërsisë shqipe.

⁶ Sh. Sinani, "Tri ligjërata universitare nga Mahir Domi", në *Akademikë dhe vepra të tyre në albanologji*, (Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2022), 117: Dorëshkrimi është një monografi ndërdisiplinore, me të dhëna jetëshkrimore, historiografike, fetare, gjuhësore, letrare, për autorin, Çetën e profetëve në dy botimet

tekstet e ligjëratave të mbajtura në gjuhë të huaj e që gjithashtu ruhen në Arkivin e Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, trashëgimia e sipërcituar vjen më e plotë e në të njëjtën kohë mbetet grishëse për sjelljen e tyre në gjuhën shqipe, ashtu si dhe vetë njohja në gjendje botimi e dorëshkrimeve që pasurojnë ndjeshëm përmbajtjen e këtij arkivi.⁷

Një shkrim që mëton të vërë në dukje kontributin e çmuar të akademik Rexhep Ismajlit në fushë të studimit të teksteve të mëhershme shqipe mbetet ai me titull *Letërsia e vjetër shqipe në shkrime e tejskrime të Rexhep Ismajlit*, sjellë në format të një trajtese sintetike, por me një sërë hollësish që arrijnë të prekin thelbin e metodologjisë kërkimore të studiuesit me një traditë shkrimore komplekse, që qëndron natyrshëm mes disa disiplinave që kanë gjetur një hapësirë ndërveprimi pikërisht falë kompleksitetit tematik e specifik të vetë veprave që e përfaqësojnë një letërsi të tillë.⁸

Studiuesi Sinani vë në një rend të arsyetuar interesat studimore të R. Ismajlit në vështrim të kësaj letërsie dhe të teksteve të së njëjtës tematikë dhe në atë të lëvruar në trevat arbëreshe, duke dalluar si dimensionin e tejskruerit, ashtu dhe atë të parashtruesit të vlerave qenësore të këtyre dëshmime shkrimore, letrare e gjuhësore. Me dimensionin e filologut, por dhe të qëmtuesit të elementeve të dosmosdoshme studimore në lidhje me autorë të veçantë të letërsisë së vjetër shqipe, me intuitën e organizuesit të veprimtarive shkencore që mbeten themelore për vetë ecurinë e gjurmimeve përkatëse, Rexhep Ismajli ka shënuar ndjeshëm disa nga orientimet kryesore në këto lamije studimi.

Një mundësi për të shprehur reflektime më të hershme mbi një studim fort të vyer të studiuesit Bahri Beci (1936-2023) përbën dhe trajtesa me titull *Dialektet si bartës kulture: E folmja e Reç-e-Dardhës në kërkimet e Bahri Becit*, në të cilën autori Sinani ka artikuluar e shtjelluar një sërë nenesh të gjurmimeve me objekt dialektologjik të B. Becit, duke i rijetëzuar dhe me

dhe për historinë e shqipes së shkruar në rrafsh krahasues midis veprave të autorëve të vjetër, sidomos midis P. Budit e P. Bogdanit.

⁷ Shih në veçanti, *ibid.*, *trajtesë e cituar*, në *Akademikë dhe vepra të tyre në albanologji*, (Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2022), 117-118: Ligjërata kushtuar traditës së letërsisë shqipe deri në periudhën e Rilindjes vijon një interesim të hershëm të studiuesit Mahir Domi, që është dhe autor i kreut të katërt të vëllimit të parë të tekstit universitar *Historia e letërsisë shqipe*, botuar më 1959 (187-195) kushtuar personalitetit të Gjon Buzukut dhe *Mesherit* të tij. Duke qenë përgatitur për një mjedis të huajsh, jo vetëm kjo, po dhe tri ligjëratat e tjera, nuk kanë asnjë ndikim qoftë dhe frazeologjik prej sloganeve të politikave kulturore e ideologjike sunduese të kohës.

⁸ Sh. Sinani, “Letërsia e vjetër shqipe në shkrime e tejskrime të Rexhep Ismajlit”, në *Akademikë dhe vepra të tyre në albanologji*, (Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2022), 191-196.

dimensionin antropogjuhësor, si dhe me interpretime të kulturës së gjuhës, që i bën këto të fundit më të përafërshme me vështrimet e ditëve të some.⁹

Vjen me një sërë vërejtjesh objektive ndaj gjendjes së përdorimit të antroponimeve dhe shkrimi me titull *Për zbulimet tradicionale në antroponimi*, kushtuar veprës së Gjovalin Shkurtajt, me anë të të cilit vihet në dukje dhe një diakroni e gjurmimit të emrave dhe mbiemrave të personave, bashkë me përkimet e mundshme në kohë më të hershme, që lidhen dhe me vetë afërsinë e dialekteve të shqipes. Autori Sinani vë në dukje dhe një mungesë lineariteti në çështje të vendosjes dhe përhapjes së disa mbiemrave në trojet shqipfolëse, bashkë me ngulmimin në disa zona për të ruajtur në trajtën genuine përdorime të caktuara, që shpjen sërish në një vetëdije më të hershme gjuhësore të shqiptarëve.¹⁰

Një vepër me rëndësi për kalendarin e shqipes paraqitet si trajtesë që i ka dhënë mundësi autorit të saj të shtjellojë gjerësisht një itinerar studimor që lidhet me profilin kompleks të Dh. Shuteriqit, i orientuar ndaj gjurmimesh në lidhje me historinë e shkrimeve shqipe dhe reflektimin e dobisë së njohjes së tyre për një sërë disiplinash shkencore.

I njohur për veprat monumentale *Shkrimet shqipe në vitet 1332-1850* (1976), *Tekstet shqipe dhe shkrimi i shqipes në vitet 879-1800* (2005) dhe *Dëshmi parabuzukiane të fjalës shqipe* (2005) dhe *Fjalori i Naim Frashërit* (2017), Dh. Shuteriqi përbën dhe sot e kësaj dite një prej autorëve më të konsultuar për orientime në disa disiplina studimi, ndër të cilat pikërisht studimi i dëshmimit shkrimor të fjalës shqipe dhe i teksteve më të hershme, përfshirë ato me destinacion letrar zënë një vend të rëndësishëm. Vëzhgime të caktuara që lidhen me trajta të veçanta të dëshmuara në dokumentime më të hershme Shuteriqi në përbërje të vëllimeve që lidhen me historinë e shkrimit shqip i kontekstualizon pikërisht në përpjekjet për ta dëshmuar sa më hershëm kulturën e të shkruarit në gjuhën tonë.¹¹ Të tilla hollësi janë bërë pjesë e një

⁹ Sh. Sinani, "Dialektet si bartës kulture: E folmja e Reç-e-Dardhës në kërkimet e Bahri Becit", në *Akademikë dhe vepra të tyre në albanologji*, (Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2022), 201-205.

¹⁰ Sh. Sinani, "Për zbulimet tradicionale në antroponimi", në *Akademikë dhe vepra të tyre në albanologji*, (Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2022), 206-208.

¹¹ Sh. Sinani, *botim i cituar*, 90: Në dallim prej dëshmive të parashqipes, që nuk i kalojnë në tërësi më shumë se një mijë leksema, dhe që në tërësinë e tyre janë thuajse të gjitha emërtime të përveçme: emra qytetesh, malesh, fisesh dhe mbretërisht, fjala shqipe e gjetur prej Dh.S.Shuteriqit ka karakterin e njësisë gjuhësore me përdorim të përgjithshëm. Ky fond fjalësh, të gjetura si mikrotekste a ndërtekste kryesisht në mjedise gjuhësore aloglote, përbën një rezervat të rëndësishme parësore për studime për një fjalor historik të shqipes, për raportet e shqipes së shkruar me atë të parashkruar,

historiku që përbën dhe një pikë lidhëse të sprovave paraardhëse në lidhje me dëshminë e shkrimit shqip deri në periudha të një dokumentimi letrar të tij.¹²

Me prirjen për të sqaruar në parim tërësinë e burimeve që janë konsultuar në proces të studimeve tematike të Shuteriqit, studiuesi Sinani dallon mes materialeve të gjendura në kronika e korpuse të natyrës historike, në të cilat gjurmohen dëshmi të rëndësishme për historinë e gjuhës e të shkrimit shqip, përfshirë trajta të përveçme që u cituan dhe më sipër, prej teksteve të tjera, të dokumentuara në periudha të një zhvillimi tjetër të kulturës së të shkruarit, që lidhet dhe me humanizmin, të trajtuar si kapitull më vete dhe në punimet e mëparshme mbi historinë e letërsisë së shkruar shqipe.¹³ Një trajtesë e tillë, e iniciuar në format recense për ribotimin e njërit prej vëllimeve të Dh. Shuteriqit mbi tekstet shqipe të viteve 879-1800, mjaft i nevojshëm për studiuesit dhe të interesuarit në fushë të gjurmimeve kryesist diakronike dhe dokumentare qëndron më së miri në një kuadër analitik mbi kontributet e shumta të këtij hulumtuesi në fushat e sipërcituara, nëse kemi parasysh dhe një trashëgimi ende të pavlerësuar plotësisht në komponentët qenësorë, nëse kemi parasysh dhe gjendjen e përmbajtjen komplekse të materialeve arkivore që ruhen në arkivat e instituteve kërkimore të vendit tonë, por dhe në vetë ato të familjes së tij.¹⁴

Në pjesën e dytë të botimit janë përfshirë një sërë trajtesash që lidhen si me historinë e letërsisë së shkruar shqipe në vështrim të rimarrjes së saj në momente të caktuara të zhvillimeve letrare shqiptare, ashtu dhe me studime

për evolucionin ndërkohor dhe për historinë e shqipes e alfabetizimit të saj në shekujt pas humanizmit evropian.

¹² Sh. Sinani, *botim i cituar*, 91: Përmes kërkimeve gjysmëshekullore për certifikimin e procesit historik të evolucionit të shqipes Dh.S.Shuteriqi arriti të koleksionojë çdo dëshmi të mundshme për të provuar ekzistencën e gjuhës shqipe prej shekujve më të hershëm deri në periudhën letrare të saj. Ai besonte se mund të dëshmonte edhe shekullin e kalimit prej gjuhës mëmë te gjuha e re, të paktën edhe një shekull më në thellësi kohore, duke iu referuar formës *Gion* të emrit të emrit të ungjilltarit të Krishtit gjetur në një kishë të fillimeve të krishtërimit të hershëm në rrethinat e Pogradecit dhe e përzgjedhi nga kronikat perëndimore e lindore dhe librat e pelegrinëve, udhëtarëve ekzotikë, misionarëve fetarë, relatorëve apostolikë dhe të notariatit laik, që kanë prekur në rrjedhë të shekujve hapësirën shqiptare për shkak të detyrës të tyre ose të pasionit për të njohur gjuhë e kultura të tjera.

¹³ Përpyekja nga ana e Shuteriqit për të dokumentuar çdo dëshmi të mundshme në lidhje me historinë e gjuhës e të dëshmimit shkrimor të shqipes pasqyrohet dhe në evidentimin e të dhënave të përveçme në kronika apo relacione të kohëve më të hershme, të cilat marrin një rëndësi të veçantë pikërisht për arsye të kohës në të cilën përmenden në burimet përkatëse. Shih sërish Sh. Sinani, *po aty, botim i cituar*, f.91.

¹⁴ Shih në veçanti trajtesën me titull “Dy studime në dorëshkrim të Dh. S. Shuteriqit”, në Sh. Sinani, *botim i cituar*, 98-105.

tematike mbi autorë të caktuar, ndër të cilët evidentohen në një rend të caktuar përfaqësues të Rilindjes sonë, por dhe të letërsisë shqipe të shekullit të kaluar, për më tepër me prurje në gjini të caktuara letrare. Në këtë pjesë të botimit të sipërcituar janë përzgjedhur pothuaj aq trajtesa sa në pjesën e parë, por ndërkohë duhet vënë në dukje që për autorë të caktuar janë rezervuar dhe shtojca që lidhen me trajtesa më të thelluara mbi përfshirjen e tyre në historinë e letërsisë së shkruar shqipe.

Në kuadrin e gjurmimeve mbi studimin e historiografisë sonë letrare spikat më së pari trajtesa me titull *Një histori letërsie e ndaluar (1968)*, me objekt çështje të njohjes së përpjekjeve për të përpiluar një vëllim të posaçëm mbi historinë e letërsisë së shkruar shqipe, krahas vëllimeve që njiheshin e që mendohet të kenë përfunduar afërsisht në fund të viteve '50 të shekullit të kaluar, duke parë dritën e botimit në vitet 1959-1960 e që mbështeten gjerësisht në kriteret kronologjike e të periodizimit të veprave të letërsisë shqipe.¹⁵ Autori bën një ekspozitë të gjerë e të domosdoshme të gjendjes së studimeve mbi vëllime të kësaj natyre, duke qenë i interesuar të shtjellojë dhe fatin e sprovave që të orientuara ndaj të njëjtit objekt, nuk panë dritën e botimit as në kohën të cilën qenë hartuar e përgatitur, e as më vonë, kur vëmendja ndaj historisë së letërsisë së shkruar shqipe mori tjetër kthesë e sigurisht u pasua nga një sërë studimesh mbi të gjitha reflektuese mbi shkallën e njohjes së saj nga studiuesit dhe studentët. Duke pasur një disponim të thelluar të të dhënave dhe nga materialet arkivore që ruhen prej vitesh në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë, duke njohur nga afër hartuesit e disa sprovave të rëndësishme në këtë vështrim, duke analizuar dhe një rend të arsyetuar të ecurisë së kësaj çështjeje, autori i kësaj trajtese ofron një analizë të qartë e të artikuluar më së miri, bashkë me nënvizimin e rëndësisë që paraqet për studimet tona dhe dalja në dritë të shtypit e një vëllimi të tretë, që për një sërë arsyesh, përfshirë dhe ato jashtëletrare, nuk arriti të përmbushej.

Le të themi që studiuesi Sinani nënvizon kësaj një shqetësim që prej kohësh e ka ndarë në rrethet kolegjiale e në ligjëratat që ka mbajtur prej vitesh në auditore dhe veprimtari shkencore, duke qenë dhe një dëshmitar real i një periudhe ndryshimesh që do të përfshinin në mënyrë të pashmangshme dhe studimet letrare, në veçanti ato në proces dhe që kishin të bënin me autorë që për tipare të shkrimtarisë, për vetë periudhën në të cilën ishin profilizuar si të tillë, do të ishin posaçërisht objekt trajtimit analitike aspak të thjeshta nga kritikët e letërsisë sonë. Analiza e rrethanave të sipërcituara në të vërtetë mbetet premisë qenësore e njohjes së faktorëve që mund të kenë penguar daljen në dritë të shtypit të një vëllimi të tretë të historisë së letërsisë së shkruar shqipe, nëse kemi parasysh si periudhën në të cilën arriti të përpilohej, si

¹⁵ Sh. Sinani, "Një histori letërsie e ndaluar (1968)", në *Akademikë dhe vepra të tyre në albanologji*, (Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2022), 229-239.

autorët që ishin menduar të ishin pjesë e saj. Një çështje e tillë duket sikur ka mbetur pa një rrugëzgjdhje, por ndërkohë vijon të jetë në pritje të saj.

Studimi në fjalë, ashtu si dhe disa të ngjashëm të të njëjtit autor në lidhje me të njëjtin argument i ka dhënë mundësi që të vërë në funksion të vetë objektivit të tij një terminologji në lidhje me tipologjinë e çështjeve të marra në analizë, ndërkohë që në vështrimin e studiuesit të historiografisë letrare shqipe të tillë terma ofrojnë një çelës për të pasur në optikën e vet si periudhat në vetvete, si dukuritë që lidhen me autorë të veçantë, ashtu dhe vetë minikontekstet që vijojnë të profilizohen sipas shkrimtarisë së secilit.¹⁶

I shkruar në vitet 1989-1990, vështrimi me titull *Midis dy Rilindjeve* përbën një parashtrësë pikëpamjesh mbi njohjen e veprës *Cuneus prophetarum* (1685) të Pjetër Bogdanit në studimet letrare dhe më tej, në një kontekst më të gjerë gjeografik. Receptimi i veprës së këtij autori që në traditën e studimeve tona i përket letërsisë së vjetër shqipe shoqërohet dhe me analiza interpretimesh mbi përmbajtjen dhe në disa raste, dhe me pikëpamje kritike mbi çka është përfshirë në të.¹⁷

Një trajtesë komplekse në të cilën shtrohen një sërë çështjesh që cekin përkimet mes sprovave në historinë e shkrimit të shqipes si dhe receptimin e Arbëreshit si karakter në letërsi është përfshirë në këtë vepër të plotë të Shaban Sinanit, i cili i rikthehet me të njëjtin preokupim kontekstualizimit të dëshmimeve shkrimore më të hershme që janë element dhe i njohjes po aq të hershme të tyre nga ana e prelatëve të botës arbëreshe dhe para vitit 1743, siç dhe është trajtuar në studime tematike mbi të njëjtën argument.¹⁸ Roli i këtyre prelatëve është nënvizuar që herët në trajtesat që mëtojnë të rindërtojnë historikun e përvijimit të dokumentimit shkrimor të gjuhës e të kulturës sonë, por gjurmohet dhe konkretisht në vepërza që reflektojnë qartë vëmendjen e tyre ndaj lidhjeve më të hershme me dheun mëmë dhe traditat përkatëse.¹⁹

¹⁶ Për çështjen e rimarrë të historisë së letërsisë së shkruar shqipe nga F. Dado shih sërish dhe Sh. Sinani, fida teorike të historiografisë letrare *po aty, botim i cituar*, 477-480.

¹⁷ Sh. Sinani, "Midis dy Rilindjeve", *ibid.*, *botim i cituar*, 251-257.

¹⁸ B. Demiraj, "Viti i zbulimit të "Mesharit" të Buzukut dhe ndonjë çështje tjetër që lidhet me të", në *Biblos*, n. 23-24, (Palermo, 2003), 47-51; M. Mandalà, "Meshari i Buzukut në Sicili", në *Milosao*, (18.5.2014).

¹⁹ Sh. Sinani, *ibid.*, *botim i cituar*, 258-259: Klerikët, mendimtarët dhe shkrimtarët arbëreshë, qenë ata që krijuan të parët mitet themelore të domosdoshme për një ideologji kombëtare: mitin e lashtësisë, mitin e prejardhjes së zgjedhur, mitin pellazgjik, mitin e lavdisë historike, mitin e heroizmit dhe të mbijetesës. Jeronim de Rada që një nyjë në të cilën konvergjuan veprimtarët shqiptarë nga të gjitha mjediset ku vepronin. Nuk ka një tjetër, në shekullin e Rilindjes Kombëtare, që të ketë pasur

Referencialiteti ndaj këtyre kontributeve merr rëndësinë e duhur sërish në këtë shkrim të Shaban Sinanit, me citime veprash në dorëshkrim të gjetura në Seminarin arbëresh të Palermos, që rezultojnë të shkruara në alfabet modern italian, siç këshillohej nga Kongregacioni i Propagandës, prej të cilit kishte parë dritën e shtypit në vitin 1635 dhe një fjalor dygjuhësh me përbërje të qartë të shqipes së asaj kohe. Adaptimi i elementeve të këtij sistemi alfabetik dhe veprat e sipërcituara e që u përkasin trevave arbëreshe interpretohet si një shenjë e qartë e ndërlidhjeve mes traditave dhe për më tepër, duhet konsideruar si pjesë e një historiku ndërveprimesh që duhet parë veçanërisht në pikëpamje ndikimesh kulturore. Përpjekje për të sjellë autorë të letërsisë arbëreshe në gjuhën tonë janë bërë më së pari nga lëvrues të kulturës së shkrimit e një fakt i tillë dëshmohet nga sprovat e Kristoforidhit për të përshtatur në toskërisht disa kangjelje të *Rapsodie d'un poema albanese* të De Radës, siç dhe nënvizohet në këtë trajtesë. Emrat e Luigj Gurakuqit, Kostaq Cipos, Sterio Spasses, Kolë Ashtës, Ziaudin Kodrës, Izet Bebeziqit, lidhen me artikuj të përpiluar gjatë gjysmës së parë të shekullit të kaluar e përbëjnë pa dyshim një kujtesë të ripërsëritur për t'i parë si përpjekje për ta përafruar letërsinë arbëreshe me studimet tona letrare.²⁰

Trajtesa e mësipërme orientohet dhe ndaj lidhjeve të mëtejme në kohë mes traditave të shkrimit e të kultivimit të letërsisë, duke arritur të veçojë dhe përpjekje të evidentuara gjatë gjysmës së dytë të shekullit XX për t'i përfshirë në të njëjtën histori letërsie, por pa lënë jashtë vëmendjes faktin e konsiderimit akoma si letërsi të ndara në pikëpamje realitetesh.²¹ Një argument i tillë e ka të domosdoshme përmasën diakronike, qoftë dhe për të vënë në dukje një vëmendje të natyrshme që buronte nga kureshtja për të njohur, për të

korrespondencën e tij, në gjendjen që është ruajtur, me mbi një mijë tituj, provë e rolit të tij si protagonist vendimtar.

²⁰ Sh. Sinani, "Arbëreshi si karakter në letërsi: kurbani ballkanik", në *Akademikë dhe vepra të tyre në albanologji*, (Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2022), 261-262: Në gjysmën e parë të shekullit XX sërish është shkencë shqiptare, dhe jo letërsia, ajo që i drejtohet e para botës arbëreshe, me disertacionin e Eqrem Çabejt *Italoalbanische Studien*, përfunduar në vitin 1933, i paraparë që të botohet në jubileun e 200-vjetorit të lindjes së Jeronim de Radës. Kjo është koha kur shenjohet dhe krjimi i së parës zonë debati kritik-letrar ndërshqiptar përmbi Adriatik, me pjesëmarrjen e papas Gaetano Petrotta-s në polemikat për poezinë e Lasgush Poradecit, krahas me Krist Malokin e Mitrush Kutelin. Por ndërmjetësi i parë i poezive të De Radës me lexuesin në Shqipëri është Namik Ressuli, i cili në vitin 1938 botoi për herë të parë në Tiranë *Milosaat*, duke ruajtur që në titull formën arkaike të titullit të veprës, një shumës i pazakonshëm për shqipen e atëhershme dhe të sotshme, që i jep fjalës kuptimin të gjitha këngët e Milosaos.

²¹ Sh. Sinani, "Arbëreshi si karakter në letërsi: kurbani ballkanik", në *Akademikë dhe vepra të tyre në albanologji*, (Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2022), 264.

evidentuar elemente tekstore nga vepra më të hershme, por që janë pjesë e çdo sprove për të rindërtuar historinë e shkrimeve më të vjetra shqipe.

Sigurisht referimi ndaj botës arbëreshe dhe gjatë shekullit XX mbetet orientim i autorit për të vënë në dukje mjaftueshmërinë relative të cekjes së lidhjeve më të hershme, por dhe të shkallës së njohjes së zhvillimeve më të fundit në zhvillimet letrare e gjuhësore në trevat përkatëse. Autorë të rëndësishëm që përfshijnë në veprat e tyre si personazhe të kësaj bote komplekse shkrimtarë që simbolizojnë poetin larg vatrës së origjinës përmenden në analiza të hollësishme, po ashtu dhe autorë që kanë dhënë kontribute me krijimtari letrare e më tej dhe me qëmtime në revista që gjithsesi kanë pasur inicim dhe vijimësi jashtë Shqipërie (rasti i Martin Camajt). Në pjesën përmbyllëse e këtij studimi të Shaban Sinanit u është rezervuar bujarisht një hapësirë e konsiderueshme analizave të veprave të këtyre autorëve (përkatësisht M. Krajës dhe M. Camajt), pa lënë jashtë vëmendjes Luan Starovën si njohës të botës arbëreshe dhe disa analiza karakteriale në vepra të veçanta të tij.²²

Një prej shkrimeve më të rëndësishme të përfshira në pjesën e dytë të këtij vëllimi mbetet dhe ai me titull *Qyteti i Kadaresë*, i përqendruar në tipologjizimin e shkrimtarisë së autorit Ismail Kadare, por dhe në evidentimin e një sërë tiparësh që evidentohen në gjurmët e veprave të tij kryesore.²³

Kontekstualizimi i përveçimeve që lidhen me qytetin dhe qytetërimin bëhet në një analizë të kujdesshme të krijimeve më të rëndësishme të shkrimtarit Ismail Kadare, në një trajtesë që introduktohet nga të dhëna që lidhen me historinë më të hershme të viseve që lidhen me Gjirokastrën, të bërë objekt prej tij në më se një vepër.²⁴ Trajtesa merr formën e një shkrimi që përfshin dhe vështrime që vijnë në parathëniet që shoqërojnë përkthimet në gjuhë të tjera të veprave në prozë, ndër të cilat dhe *Dimri i vetmisë së madhe*, i përmendur dhe për kritikën e kushtëzuar të kohës në të cilën u përftua.²⁵ Qyteti dhe qytetërimi, letërsia qytetare, personazhet tipike dhe përfytyrimet që dalin në veprat me një tematikë të lidhur me arkitekturën urbane, elementet qenësore

²² Shih në veçanti paragrafet kushtuar romanit *Kurbani ballkanik* të L. Starovës, ibid., *botim i cituar*, 268-269.

²³ Sh. Sinani, "Qyteti i Kadaresë", ibid., *botim i cituar*, 327-347.

²⁴ Sh. Sinani, "Qyteti i Kadaresë", ibid., *botim i cituar*, 332: Qytetërimi i jetës shqiptare, që është mision i veprës së Kadaresë, para së gjithash realizohet në ciklin e vendlindjes, ciklin e Gjirokastrës, që përveç *Qytetit të Jugut*, të cilin nuk mund ta shohim jashtë një lidhjeje të figurshme me *Qytetin e Veriut* të Migjenit (ashtu siç nuk mund t'i ndajmë, për shkak të asociacionit detyruar, *Na t'birt e shekullit të ri* të Migjenit dhe poemën *Shekulli im të Kadaresë*), bashkon me lidhje gjenetike-strukturore shumicën e veprave të tij.

²⁵ Sh. Sinani, "Qyteti i Kadaresë", ibid., *botim i cituar*, 330.

të saj, gjurmët e lëna në të nga paraardhësit, ngjarjet historike që autori ka zgjedhur të përshkruajë e analizojë, kritika letrare në më se një kohë, domosdoshmëria për ta tipologjizuar rishtas shkrimtarinë e autorit Ismail Kadare dalin në pah në proces të shtjellimit të kësaj trajtese. Rikrijimi i motiveve të vendlindjes në veprën letrare të Ismail Kadaresë përbën dhe një shtysë për të ndërtuar krahasime me autorë të cilën ndjekin të njëjtin proces në shkrimtarinë e tyre. Një analizë e tillë bën të mundur përsiatje që kapërcejnë kufij gjeografikë e kohorë, duke drejtuar vëmendjen dhe në shkrimtarë të rëndësishëm që kanë ndikuar në konceptimet tona mbi letërsinë humaniste, por dhe mbi letërsinë e qytetit në veçanti.

Një tjetër trajtesë e zgjeruar, pikërisht *Tipologjia e lirikës së Naim Frashërit*, e iniciuar si një vlerësim kritik për veprën me të njëjtin titull të J. Bulos përbën në të vërtetë një hapësirë për të shprehur pikëpamjet mbi domosdoshmërinë e vështrimeve të reja mbi veprën e autorit rilindas që jetoi në harkun kohor 1846-1900, vëmendja ndaj të cilit përqendrohet dhe në krijime me një gjurmë të qartë epike.²⁶ Janë shtruar kësisoj një sërë perspektivash që nxisin dhe ndaj vështrimit të veprës së këtij autori në optikën e raportit mes zhanreve të lëvruara prej tij, por dhe të evoluimit të mendimit studimor mbi dijen letrare dhe vëzhgimet e kohëve të fundit mbi letërsinë e Rilindjes sonë. Një vështrim objektiv që tejkalon kritikën e deritanishme mbi këtë autor, bashkë me një vlerësim mbi çka mund t'i vyejë dijes së sotme mbi gjendjen e studimeve mbi këtë periudhë të letërsisë sonë si dhe me një sërë paralelesh të mundshme krahasimi konstruktiv gjindet pikërisht në këtë trajtesë të sipërcituar të studiuesit Sinani.²⁷

Migjeni i Dritëro Agollit përbën një tjetër trajtesë të zgjeruar që i ka krijuar hapësirë studiuesit Sinani t'u rikthehet çështjeve të historikut të njohjes e të risjelljes së veprës së Migjenit, me një sërë trajktoresh që kushtëzohen nga disa rrethana, por ndaj të cilave mbizotëron një qasje krejt origjinale që mbështetet nga njohja e teksteve migjeniane dhe nevoja e përfshirjes së tyre në

²⁶ Sh. Sinani, *ibid.*, *botim i cituar*, 465-476.

²⁷ Sh. Sinani, *ibid.*, *botim i cituar*, 468: Studimi i tipologjisë së figurës, të kodit poetik dhe të gjedhes krijuese bën të nevojshëm krahasimin e brendshëm dhe të jashtëm me traditën e vendit dhe me zhvillimet kryesore letrare me ndikim ndërkombëtar, sepse kodet poetike, nga vetë burimi dhe funksioni i tyre, janë ndërkombëtare. Në njëfarë mënyre shtrimi i çështjes së tipologjisë së figurës në veprën e Naimit është njëherësh edhe praniam i debatit për rolin e një teknike poetike ndërkombëtare për afirmimin e poetit kombëtar. Vetvetiu kjo e zhvendos poetin në një bashkësi tjetër nga ajo e studimeve tradicionale, prej shoqërive atdhetare shqiptare të Rilindjes midis një bote emrash të shquar që japin e marrin me të prej epokash dhe botësh krejt të ndryshme.

një kuadër të mirëfilltë socioletrar.²⁸ Këto çështje të sipërcituara rimerren imtësisht pas trajtimit tematik dhe tipologjik të tezës së Dritëro Agollit mbi Migjenin, duke i dhënë dhe vetë trajtesës një frymëmarrje të gjerë në pikëpamje të rrokjes së argumenteve të trajtuara.

Në këtë përmbledhje studimesh, recensionesh e rivështrimesh mbi çështje të historisë së shkrimit të shqipes, çështje të njohjes së autorëve të veçantë të historisë së letërsisë shqipe, çështje të ndërlidhjes mes traditash që në të vërtetë janë tharmi i një substrati të hershëm që përbashkon prirje e vepra të kulturës shqiptare, kanë gjetur vend dhe trajtesa që kanë marrë shtysë nga vepra të iniciuara mbi qasje ndërdisiplinore e që mbeten të tilla dhe në konceptim e shtjellim.²⁹ Shkrime sintetike që u kushtohen veprave që orientohen në muzikologji e letrarësi³⁰, por dhe vështrime antropologjike e juridike janë pjesë e këtij korpusi, duke pasuruar përmbajtjen e vëllimit në fjalë.

²⁸ Sh. Sinani, *ibid.*, *botim i cituar*, 380-408. Bëhet fjalë për punimin me titull *Skicat dhe tregimet e shkrimtarit revolucionar shqiptar Migjeni* të D. Agollit, mbrojtur në fund të viteve '50 të shekullit të kaluar në Universitetin Shtetëror Zhdanov të Petersburgut, cituar nga autori i trajtesës dhe në pikëpamje të fushës përkatëse të studimit e të vështrimit recensues të A. Desnickaja.

²⁹ Shih në veçanti shkrimin me titull "Etnosi shqiptar dhe eposi shqiptar në vështrimin e A. Budës", *ibid.*, *botim i cituar*, 493-512.

³⁰ Shih në veçanti shkrimin me titull "Kadare dhe muzika", *ibid.*, *botim i cituar*, 481-492.

